

**AKT I THEMELIMIT DHE STATUTI I
SHOQËRISË AKSIONARE**

“NOVABET” SHA



AKT I THEMELIMIT DHE STATUTI I

SHOQËRISË AKSIONARE

NENI 1 Perkufizime

1.1 Në këtë dokument, nëse nuk përcaktohet ndryshe, termat e mëposhtme kanë këto kuptime:

“Ligji Tregtar”: Ligji Nr. 9901 date 14.04.2008 “Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar;

“Statuti” Statut i shoqërisë Aksionare NOVABET SHA, e themeluar si një shoqëri aksionare (SHA) sipas legjislacionit shqiptar;

“Aksionar(ët)” Sipas rastit, personat fizik ose juridikë qe zoterojnë aksionet e Shoqërisë.

“Person” Çdo person fizik apo juridik;

“Trashëgimtar” personi që sipas ligjit, është trashëgimtar universal i të gjitha të drejtave dhe detyrimeve të Aksionarit apo ka të drejte në lidhje me zotërimin dhe/ose përfitimin e çdo të drejte ligjore mbi pasuritë e Aksionarit si pasojë e vdekjes së tij, transformimit, prishjes së shoqërisë, falimentimit/likuidimit dhe çdo mjeti tjetër ligjor;

“Website” Hapësira zyrtare e internetit të Shoqërisë;

**“Unanimitet” ose
“Vendim Unanim”** Marrja e vendimeve me miratimin e të gjithë aksionarëve të Shoqërisë.

“Data e Krijimit” 27.01.2025

1.2 Të gjitha njoftimet, kërkesat ose komunikimet e tjera që Shoqëria i drejton Aksionarëve sipas këtij Statuti, do të bëhen me shkrim dhe do të konsiderohen të kryera në mënyrë të rregullt kur u dërgohen Aksionarëve në adresat e regjistruara në Qendrën Kombëtare të Biznesit të Shoqërisë sipas nenit 15 të këtij Statuti, në bazë të deklarimeve qe Aksionarët i bëjnë Këshillit të Mbikeqyres të Shoqërisë.

1.3. Të gjitha njoftimet zyrtare, kërkesat, ose komunikimet e tjera që Shoqëria i drejton Aksionarëve sipas këtij Statutit, do të konsiderohen të kryera rregullisht në adresat e Aksionarëve kur njoftimi, kërkesa apo komunikimi është: (i) dërguar personalisht, (ii) dërguar me poste rekomande ose me kthim përgjigje, ose i është (iii) dorëzuar një shoqërie ndërkombëtare të mirënjosur të shërbimit të shpejtë postar, në adresën e regjistruar në Regjistrin e Aksioneve të Shoqërisë.

- 1.4 Të gjitha njoftimet zyrtare, kërkesat ose komunikimet e tjera që Shoqëria i drejton Aksionarëve sipas këtij Statuti, do të konsiderohen të marra ne mënyrë te rregullt nga Aksionari në datën më të hershme, ndërmjet: (i) datës së marrjes efektive ose refuzimit te pranimit nga ana e Aksionarit marrës ose (ii) datës së njoftimit të kthimit nga shërbimi postar, ose datës së depozitimit të njoftimit për llogari të Aksionarit marrës, në zyrën vendore të shoqërisë përkatëse ndërkontaktore të mirënjoinur të shërbimit të shpejtë postar.
- 1.5 Të gjitha njoftimet zyrtare, kërkesat ose komunikimet e tjera që Shoqëria i drejton Aksionarëve sipas këtij Statuti mund të kryhen me mjete elektronike. Njoftimet zyrtare të komunikimeve me anë të mjeteve elektronike vërtetohen sipas legjisacionit mbi nënshkrimin elektronik dhe u dërgohen Aksionarëve në adresat elektronike të deklaruara prej tyre.
- 1.6 Në kuptim te këtij Statuti, shprehjet në numrin njëjës përfshijnë ato në numrin shumës dhe anasjelltas, me përjashtim të rastit kur sipas kontekstit të dispozitës përkatëse rezulton ndryshe. Përemri vетор “ai” përfshin edhe përemrin vетор “ajo” dhe përemri vетор “ata” i nënkuption të dyja gjinitë, me përjashtim të rastit kur sipas kontekstit të dispozitës përkatëse rezulton ndryshe.

TITULLI I
Aksioneret, Emri, Qëllimi, Kohëzgjatja, Selia, Website

NENI 2
Aksioneret, Emri

- 2.1 Shoqëria “REGENCY INTERNATIONAL CASINO TIRANA” SHA e krijuar dhe funksionon sipas legjisacionit shqiptar, me seli ne Rrugë Deshmoret e 4 Shkurtit, Parku Rinia, Kompleksi Taiwan, Zona, Kadastrale 8380, Tirane, Shqiperi, themeluar dhe regjistruar si person juridik shqiptar me NIPT K51711801L, perfaqesuar nga Administratori Z. Lulzim Merdani shtetas Shqiptar, lindur me 21.07.1967, ne Berat, i pajisur me Leternjoftimin me Nr. Personal G70721094L, shoqeri e cila zoteron 100 % te aksioneve te Shoqerise NOVABET SHA.
- 2.2 Emri i Shoqerise eshte: **“NOVABET” SHA**

NENI 3
Objekti i Shoqërisë

- 3.1 Objekti i aktivitetit te Shoqerise eshte:

- Baste Sportive Online
- Import-eksport te pajisjeve dhe te materialeve lidhur me Baste Sportive Online.
- Çdo aktivitet tjeter lidhur me Bastet Sportive Online ne perputhje te plete me legjisacionin e zbatueshem shqiptar.

NENI 4
Kohëzgjatja

- 4.1 Shoqëria themelohet për të ushtruar aktivitetin e saj për një periudhe kohe të pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar.

NENI 5
Selia, Website dhe adresa elektronike, Pronësia Intelektuale

- 5.1 Shoqëria ka selinë e saj për qëllime te Biznesit në adresën: Rruga Deshmoret e 4 Shkurtit, Parku Rinia, Kompleksi Taiwan, Zyrat e Administratës, Kati 1, Zona Kadastrale 8380, Tirane.
- 5.2 Shoqëria ka website-in e saj zyrtar.
- 5.3 Shoqëria do të ketë adresat e saj zyrtare për komunikimet elektronike.
- 5.4 Shenjet dalluese të aktivitetit ekonomik, të adresave elektronike dhe të Website mund të njoftohen vullnetarisht në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- 5.5 Markat tregtare/patentat dhe pronësítë e tjera intelektuale të Shoqërisë mund të regjistrohen në përpunhje me legjislacionin mbi pronësinë intelektuale

TITULLI II
Kapitali i Regjistruar, Kontributet, Aksionet, Aksionarët

NENI 6
Kapitali i Regjistruar, Themeluesit

- 6.1 Kapitali i regjistruar i Shoqërisë, është 50 000 000 leke (pesedhjete milion leke) Lekë, i cili ndahet në 50 000 (pesedhjete mijë) aksione të zakonshme, me vlerë nominale 1000 (një-mijë) Lekë secila. Aksionet e Shoqërisë nënshkruhen e paguhen në para nga Themeluesi, siç përcaktohet në Aneksin I bashkëngjitur këtij Statuti si pjesë përbërëse e tij.

NENI 7
Aksionarët, Aksionet, Kontributet,

- 7.1 Aksionarët e Shoqërisë do të janë personat të cilët kanë fituar aksionet e tyre në mënyrat e përcaktuara nga Ligji Tregtar dhe dispozitat e këtij Statuti.
- 7.2 Aksionet e Shoqërisë mund të janë të kategorive të ndryshme, sipas vendimeve të Asamblesë së Aksionarëve (aksione të zakonshme, me përparësi, me ose pa të drejtë vote). Aksionet që jepin të njëjtat të drejta, përbëjnë aksione të së njëjtës kategori. Të drejtat e përparësisë që burojnë nga aksionet më përparësi vendosen nga Asambleja e Aksionarëve me të njëjtën shumicë të kërkuar nga Ligji Tregtar për ndryshimin e statutit. Këto vendime do të përbëjnë pjesë të këtij Statuti. Të drejtat e përparësisë të shënuara në Statut do të konsiderohen shteruese. Çdo aksion do të ketë të njëjtën vlerë nominale. Kriteret e vlerësimit dhe procedurat për shndërrimin e aksioneve nga një klasë në tjetrën, si dhe për shndërrimin e obligacioneve e titujve të tjerë, vendosen nga Asambleja e Aksionarëve me të njëjtën shumicë të kërkuar nga Ligji Tregtar për ndryshimin e Statutit.
- 7.3 Aksionet që do të emetohen sipas vlerave të kapitalit themeltar përcaktuar në këtë Statutit, apo sipas zmadhimit të kapitalit miratuar nga Asambleja e Aksionarëve, duhet të nënshkruhen nga Aksionarët jo më vone se 15 Ditë të Plota nga dita e miratimit të vendimit (apo e nënshkrimit të Statutit), apo në rastet kur kjo kërkohet me Ligj, nga dita e miratimit të prospektit nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare. Aksionari që brenda këtij afati, pa arsyë të justifikuara, nuk kryhen nënshkrimin aksioneve të reja që do të emetohen, konsiderohet se ka hequr dorë nga të drejtat e parablerjes sipas nenit 7 të këtij



Statuti. Asambleja e Përgjithshme mund të parashikojë afate të ndryshme me miratimin e zmadhimit te kapitalit.

- 7.4 Aksionet e nënshkruara me kontribut në para duhet të shlyhen të paktën në një të katërtën e vlerës së tyre nominale përpëra, sipas rastit, Biznesit të Shoqërisë apo Biznesit të realizimit të zmadhimit të kapitalit në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Shumat që mbeten shlyhen në një ose më shumë këste, sipas Aktit të Emetimit të Aksioneve, apo sipas kushteve e afateve të përcaktuara nga Asambleja e Aksionarëve. Primet mbi aksionet e nënshkruara me kontribut në para duhet të shlyhen tërësisht përpëra Biznesit të realizimit te zmadhimit te kapitalit në Qendrën Kombëtare të Biznesit
- 7.5 Në rast se aksionet nënshkruhen me kontribute në natyrë, këto kontribute duhet t'i kalohen tërësisht Shoqërisë përpëra të realizimit të zmadhimit të kapitalit në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Vlerësimi i kontributeve në natyrë do të kryhet në përputhje me parashikimet e Ligjit Tregtar.

TITULLI III Veprime me Kapitalin, me Aksionet, Regjistri i Aksioneve

NENI 8 Zmadhimi i Kapitalit

- 8.1 Asambleja e Aksionarëve, nëpërmjet një Vendimi të Jashtëzakonshëm, mund të zmadhojë kapitalin e regjistruar të Shoqërisë sipas parashikimeve të Ligjit Tregtar.
- 8.2 Secili Aksionar ekzistues, proporcionalisht me totalin e aksioneve të zotëruara, do të ketë të drejtën të nënshkruajnë Aksionet që do të emetohen si pasojë e zmadhimit, duke u preferuar ndaj çdo të treti. Kjo e drejtë mund të kufizohet në bazë të një vendimi të Asamblesë së Aksionarëve sipas kërkesave të nenit 174(2) të Ligjit Tregtar.
- 8.3 Asambleja e Aksionarëve, me miratimin unanim, mund të vendosë që zmadhimi i kapitalit të kryhet me emetim të aksioneve të reja, për t'u nënshkruar vetëm nga aksionarët ekzistues.
- 8.4 Zmadhimi i kapitalit konsiderohet i realizuar pas përfundimit të afatit të caktuar për nënshkrimin e aksioneve, përcaktuar në Statut ose sipas vendimit te Asamblesë së Aksionarëve, dhe vetëm për pjesën e vlerës së zmadhimit që efektivisht është nënshkruar.
- 8.5 Shoqëria mund të zmadhojë kapitalin edhe sipas mënyrave, kushteve e procedurave të tjera të parashikuara nga Ligji Tregtar, të ndryshme nga sa parashikon ky nen. Në këto raste, dispozitat e këtij Statut janë të zbatueshme për sa është e mundur, në lidhje me zmadhimin e kapitalit sipas mënyrave, kushteve e procedurave të tjera të parashikuara nga Ligji Tregtar.

NENI 9 Njoftimi i Zmadhimit, Regjistrimi i Realizimit të Zmadhimit të Kapitalit

- 9.1 Shoqëria njofton pranë QKB vendimin e për zmadhimin e kapitalit sipas afateve e kërkesave të Ligjit për QKB.

- 9.2 Vendimi Asamblesë së Aksionarëve për zmadhimin e kapitalit publikohet edhe në faqen e internetit të Shoqërisë, nëse ka.
- 9.3 Regjistrimi i zmadhimit të kapitalit në Qendrën Kombëtare të Biznesit kryhet vetëm në lidhje me shumave të zmadhimit të kapitalit që i përkasin Aksioneve të nënshkruara, në përputhje me kushtet e nenit 169 të Ligjit Tregtar (regjistrimi i Realizimit të Zmadhimit).
- 9.4 Me përfundimin e nënshkrimit të aksioneve sipas afateve të kërkuara, Shoqëria regjistron në QKB Realizimin e Zmadhimit, dhe depoziton listën e plotë të personave që kanë nënshkruar aksionet, së bashku me shumat e parapaguara, dhe/ose sipas rasit, aktet e vlerësimit të kontributeve në natyrë, kur aksionet janë nënshkruar me kontribute në natyrë. Nëse zmadhimi realizohet brenda afateve të kërkuara për njoftimin pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit të vendimit që miraton zmadhimin sipas paragrafit 1 më sipër, atëherë Shoqëria njëkohësisht njofton vendimin dhe regjistron Realizimin e Zmadhimit të kapitalit.
- 9.5 Regjistrimi i Realizimit të Zmadhimit të kapitalit i nënshtronhet gjithashtu kushteve të tjera të përcaktuara nga Ligji Tregtar për zmadhimin e kapitalit në raste të veçanta
- 9.6 Zmadhimi i kapitalit bëhet efektiv në datën e realizimit të tij në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

NENI 10 Zvogëlimi i Kapitalit

- 10.1 Asambleja e Aksionarëve, nëpërmjet një Vendimi të Jashtëzakonshëm mund të zvogëlojë kapitalin e regjistruar të Shoqërisë.
- 10.2 Në rastet kur zvogëlimi i kapitalit nuk kryhet për shkak të humbjeve të aktivitetit tregtar, Asambleja e Aksionarëve mund të vendosë të anulojë një a më shumë aksione në përputhje me Nenin 13 të këtij Statuti, si dhe të dispozitave të Ligjit Tregtar, e në veçanti të nenit 149 të këtij ligji.
- 10.3 Zvogëlimi i kapitalit regjistrohet e publikohet pa vonesa pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Kapitali quhet i zvogëluar, duke filluar nga çasti i Biznesit të vendimit.
- 10.4 Kapitali i regjistruar mund të zvogëlohet nën vlerat minimale, të parashikuara nga Ligji Tregtar, vetëm në rastin kur zvogëlimi shoqërohet me një zmadhim të njëkohshëm të kapitalit.

NENI 11 Transferimi i Aksioneve

- 11.1 Aksionet e Shoqërisë mund të transferohen sipas parashikimeve të Ligjit Tregtar si dhe duke respektuar te gjitha kufizimet per ndryshimet e pronesise se aksioneve per te licencuarit ne perputhje me parashikimet e Ligjit Nr.155/2015 “Për Lojërat e Fatit në Republikën e Shqipërisë”.
- 11.2 Shoqëria nuk mund të blejë Aksionet e saj.



NENI 12
Regjistri i Aksioneve

- 12.1 Shoqeria harton një regjistër të posaçëm, ku regjistrohen të dhënat përcaktuara sipas Ligjit Tregtar në lidhje me të gjitha aksionet e Shoqërisë.
- 12.2 Personat e regjistruar në regjistrin e aksioneve prezumohen Aksionarë të Shoqërisë me të drejtë të plota si për marrëdhëniet me Shoqërinë, ashtu dhe ndaj të tretëve. Aksionet e të drejtat e fituara mbi to, nuk mund të ushtrohen ndaj asnjë personi apo ndaj Shoqërisë, përpala se veprimi të jetë regjistruar në regjistrin aksioneve që mban Shoqëria.
- 12.3 Shoqeria njofton, herë pas here, dhe brenda afateve të kërkua, të dhënat e regjistrat të aksioneve të shoqërisë sipas kërkesave ligjore, dhe veçanërisht listën e aksionarëve, pranë QKB në përputhje me Ligjin Për Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe në përputhje me dispozitat e Ligjit për Titujt.
- 12.4 Çdo Aksionar mund ti kërkojë Shoqërisë lëshimin e një vërtetimi mbi të dhënat e tij të Biznesit në regjistrin e aksioneve të shoqërisë. Në bazë të vendimit të Asamblesë së Aksionarëve, Shoqëria mund të lëshojë çertifikata për vërtetimin e zotërimit të Aksionit.

NENI 13
Asambleja e Përgjithshme

- 13.1 Asambleja e Pergjithshme eshte organi me i larte i shoqerise e cila perbehet nga Aksionaret e Shoqerise. Ajo vendos mbi te gjitha ceshtjet ne kompetence te saj dhe vendimet e saj jane te detyrueshme per Aksionaret. Asambleja e Pergjithshme ka kompetence ekskluzive per ndryshimin e statutit.

NENI 14
Asambleja e Përgjithshme
Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme

- 14.1 Mbledhja e Asamblesë së Aksionarëve thirret në përputhje me Ligjin Tregtar nga çdo anëtar Këshilli apo çdo Administrator, sa herë që e konsiderojnë të arsyeshme për mbarëvajtjen e aktivitetit të Shoqërisë apo sa herë që thirrja e Asamblesë së Aksionarëve është e detyrueshme sipas Ligjit Tregtar ose dispozitave të tjera ligjore. Mbledhja e Asamblesë së Aksionarëve mund të thirret edhe nga Personat e tjerë të përcaktuar sipas Ligjit Tregtar. Mbledhja e Asamblesë së Aksionarëve duhet të thirret të paktën një herë gjate një viti finanziar për miratimin e bilancit vjetor.
- 14.2 Mbledhja e Asamblesë së Aksionarëve thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë apo me mjete elektronike, në përputhje me aktet e nënshkrimit elektronik, drejtuar çdo Aksionari. Thirrja e Asamblesë së Aksionarëve duhet të njoftohet të paktën 21 (njëzetë e një) kalendarike përpala datës së mbledhjes. Njoftimi duhet të përbajë të dhënat dhe informacionin e përcaktuar në nenin 137 të Ligjit Tregtar. Në rast se mbledhja mbahet me mjete komunikimi, të ndryshme nga prania e njëkohshme e pjesëmarrësve në një vendndodhje të caktuar, përfshi këtu komunikimin me mjete elektronike, Aksionarëve i njoftohen gjithashtu mënyrat e komunikimit dhe të vërtetimit të identitetit e nënshkrimeve (në rastet e komunikimeve elektronike, sipas legjisacionit përkatës për nënshkrimin elektronik).

- 14.3 Aksionarët nuk mund të kërkojë shpalljen e pavlefshmërisë së mbledhjes së Asamblesë për shkak të mungesës së njoftimit, nëse Aksionari i ka dhënë Shoqërisë një adresë të pasaktë (përfshi adresën elektronike) për regjistrim pranë Regjistratit të Aksioneve, apo nuk ka njoftuar ndryshimin e adresës (përfshirë adresën elektronike) përparrë nisjes së njoftimit.

NENI 15
Punimet e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

- 15.1 Asambleja e Aksionarëve nuk mund të kryejë punime e të marrë asnjë vendim nëse nuk është plotësuar kuorumi i parashikuar në Nenin 144 të Ligjit Tregtar. Aksionarët mund të marrin pjesë në mbledhje nëpërmjet caktimit të përfaqësuesve, nëpërmjet telekonferencës, audio ose video, si dhe të mjeteve të tjera elektronike në përputhje me Nenin 142 të Ligjit Tregtar (Aksionarët e Pranishëm). Aksionarët që marrin pjesë nëpërmjet mjeteve elektronike mund të votojnë elektronikisht në mbledhje, pas verifikimit të identitetit të tyre në mënyrë elektronike sipas kërkësave të nënshkrimit elektronik, të përcaktuar në njoftimin e thirrjes
- 15.2 Administratori do të kryesojë Asamblenë e Aksionarëve dhe do të caktojë një person si mbajtës të procesverbalit. Aksionarët e Pranishëm me të drejtë vote, me shumicën e $\frac{3}{4}$ të votave të zotëruara prej tyre, mund të vodosin që mbledhja të kryesohet nga një person tjeter.
- 15.3 Nëse Administratori nuk është i pranishëm apo nuk dëshiron të veprojë si Kryetar i Asamblesë, Aksionarët e Pranishëm me të drejte vote, me shumicën e $\frac{1}{2}$ të votave të zotëruara prej tyre, do të caktojnë Kryetarin dhe personin që do të mbajë procesverbalin e mbledhjes.
- 15.4 Anëtarët e Këshillit të Mbikeqyres dhe Administratorët kanë të drejtën të marrin pjesë në çdo kohë në mbledhjet e Asamblesë së Aksionarëve.
- 15.5 Kryetari, përparrë nisjes së punimeve të mbledhjes së Asamblesë së Aksionarëve, verifikon numrin e Aksionarëve të pranishëm personalisht, me mjete elektronike apo nëpërmjet përfaqësuesve të autorizuar, si dhe identitetin e numrit e votave të zotëruara nga secili prej tyre, plotësimin e kuorumin përmbytjeje dhe kuorumin e nevojshëm përmarrjen e vendimeve sipas rendit të ditës, duke i plotësuar në listën e pjesëmarrësve. Lista e Pjesëmarrësve përmbytjeje të dhënët e mësipërme dhe nënshkruhet nga secili pjesëmarrës.

NENI 16
Votat e Aksionarëve

- 16.1 Në varësi të së drejtave ose kufizimeve që lidhen me Aksionet, secili Aksion i zakonshëm mbart të drejtën e 1 (një) vote në mbledhjen e Asamblesë së Aksionarëve. Aksionari mund të përjashtohet nga e Drejta e Votës sipas parashikimeve të Ligjit Tregtar dhe të këtij Statuti. Aksionarët e Pranishëm detyrohet të votojnë në mënyrë uniforme për të gjitha aksionet e zotëruara prej tyre.
- 16.2 Vendimet e Asamblesë merren sipas shumicës përkatëse të votave, përcaktuar në këtë Statut dhe në Nenin 145 të Ligjit Tregtar.

- 16.3 Vendimet Asamblesë miratohen me votim të hapur nëse përpara deklarimit të rezultatit nuk është kërkuar një votim i fshehtë. Votimin i fshehtë mund të kërkohet nga Kryetari ose nga Aksionarët e Pranishëm që zotërojnë jo më pak se 5% të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë.
- 16.4 Nëse nuk kundërshtohet nga një Aksionar, deklarimi i Kryetarit në lidhje me miratimin apo mosmiratimin e një vendimi nga Asambleja e Aksionarëve, si dhe shumica me të cilën është votuar regjistrohet në procesverbalin e mbledhjes dhe konsiderohet vendim i formës së prerë, pa qenë e nevojshme prova për numrin apo përqindjen e votave të regjistruar pro ose kundër vendimit. Nëse ka kundërshtime, ky fakt shënohet në procesverbal, dhe Kryetari numëron votat pro ose kundër, dhe nëse ka paqartësi, Asambleja voton për herë të dytë çështjen.
- 16.5 Mënyrat e votimit të fshehtë përcaktohen në rregulloren e punimeve të Asamblesë se Përgjithshme. Në rastin e votimit me mjete elektronike, mënyra e votimit duhet të garantojë fshehtësinë e votës.
- 16.6 Të gjitha vendimet e Asamblesë së Aksionarëve regjistrohen në procesverbalin e mbledhjes. Prosesverbalit përmban datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e Kryetarit dhe të mbajtësit të procesverbalit, mënyrën e mbajtjes së mbledhjes dhe të votimit, rezultatet e votimit, regjistrimin në lidhje me diskutimet e mbledhjes dhe çështjet e tjera që duhet të shënohen në të sipas Ligjit Tregtar apo rregullore së punimeve të Asamblesë se Përgjithshme.
- 16.7 Prosesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, autorizimet për votim (nëse ka), si edhe akti i thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme. Në rastin kur mbledhja zhvillohet me mjete elektronike, procesverbalit i bashkëngjiten kopjet e printuara të dokumenteve elektronike që vërtetojnë pjesëmarrjen e nënshkrimin elektronik. Prosesverbalit i mbledhjes, lista e pjesëmarrësve e dokumentet e tjera të bashkëlidhura, nënshkruhen nga Kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.
- 16.8 Administratori përgjigjet për ruajtjen e procesverbaleve të mbledhjeve të Asamblesë së Aksionarëve. Kur procesverbalit përmban të dhëna konfidenciale për aktivitetin e Shoqërisë, mund të nxjerrin ekstrakte.
- 16.9 Administratori jo më vonë se 15 ditë nga mbledhja i njofton Aksionarëve apo përfaqësuesve të tyre kopje të procesverbalit, dhe nëse është vendosur nga Asambleja e publikon atë në një seksion të vecantë të *website* të aksesueshëm vetëm nga Aksionarët.
- 16.10 Nëse mbledhja mbahet nëpërmjet komunikimeve elektronike, ajo konsiderohet e mbajtur në orën vendin e selisë së Shoqërisë.

NENI 17 **Përfaqësimi në Asamble**

- 17.1 Aksionari mund të autorizojë persona të tjerë sipas dispozitave të Ligji Tregtar për ta përfaqësuar atë në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme. Autorizimi bëhet me shkrim. Një aksionar nuk mund të autorizojë persona të ndryshëm që ta përfaqësojnë në lidhje me pjesë të aksioneve të tij.

- 17.2 Autorizimi origjinal me shkrim apo një kopje e noterizuar ose e vërtetuar nga Administratoret apo persona të tjerë të autorizuar, duhet të depozitohet në selinë e Shoqërisë jo më vonë se 24 orë përpara orës së datës së caktuar për mbledhjen e Asamblesë se Përgjithshme. Asnjë person nuk do te lejohet të përfaqësojë një aksionar në mbledhjen e Asamblesë nëse autorizimi është depozituar mbas këtij afati.
- 17.3 Autorizimi mund të jepet me mjete elektronike, me kusht që të jepet sipas formatit të përcaktuar në këtë Statut, nënshkrimi të vërtetohet në përputhje me legjislacionin mbi nënshkrimin elektronik dhe autorizimi të dërgohet, jo më vonë se 24 orë përpara orës së datës së caktuar për mbledhjen e asamblesë, nëpërmjet një mesazhi elektronik në adresën e postës elektronike të Shoqërisë që i është njofuar Aksionarëve.

TITULLI IV **Administrimi i Shoqërisë**

NENI 18 **Emërimi, Shkarkimi i Këshillit Mbikeqyres, Kompetencat**

- 18.1 Keshilli Mbikeqyres perbehet nga 3 (tre) anetare, vetem persona fizik.
- 18.2 Keshilli Mbikeqyres vlereson zbatimin e politikave te Shoqerise dhe kontrollon përputhshmerine e tyre me kete statut dhe Ligjin Tregtar. Anëtarët e Këshillit të Mbikwqyrws mund të përfitojnë shpërblime ose të ardhura, përfshirë pjesë nga fitimet e Shoqërisë.
- 18.3 Anetaret e Keshillit Mbikeqyres caktohen ne përputhje me Ligjin Tregtar. Anetaret e Keshillit Mbikeqyres duhet te jene te pavarur.
- 18.4 Anetaret e Keshillit Mbikeqyres zgjidhen nga Asambleja e Pergjithshme me shumice te thjeshte per një periudhe 3 (tre) vjecare me te drejtë rizgjedhjeje.
- 18.5 Te drejtat dhe detyrat e keshillit mbikeqyres:
- Te emeroje dhe shkarkoje Administratorin;
 - Te kontrolloje dhe te mbikeqyre zbatimin e politikave tregtare te Shoqerise nga Administratori;
 - Te pergatise, me kerkese te Asamblese se Pergjithshme, marrjen e masave, qe jane ne kompetence te kesaj te fundit, ti rekomandoj asaj vendime te nevojshme per tu marre, si dhe te zbatoje vendimet e Asamblese se Pergjithshme;
 - Te therrase Asamblene e Pergjithshme, sa here vleresohet e nevojshme per interesat e shoqerise.
 - Te kujdeset qe Shoqeria te respektoje ligjin dhe standartet e kontabilitetit.
 - Te marre çdo vendim tjeter ne përputhje me parashikimet e Ligjit per Shoqerite Tregtare.

NENI 19 **Administratorët**

- 19.1 Këshilli Mbikeqyres emëron një ose më shumë persona fizikë si Administrator(ë) të Shoqërisë. Administratori(ët) emërohen sipas afatit të vendosur nga Këshilli Mbikeqyres në aktin e emëritit. Në rast heshtje, emërimi konsiderohet i bërë për një afat prej 3 vitesh.

Administratori(ët) mund të riemërohen.. Asambleja e Aksionarëve mund të vendoset rregulla në lidhje me emërimin e Administratorëve.

- 19.2 Administratori(ët) është përfaqësuesi ligjor i Shoqërisë, dhe ka të drejtë të përfaqësojë Shoqërinë në marrëdhëniet me të tretet.
- 19.3 Tagrat e përfaqësimit të administratorëve dhe çdo ndryshim i tyre regjistrohen pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit në përputhje me dispozitat e Ligjit Tregtar. Administratorët, të cilët kanë të drejtë ta përfaqësojnë Shoqërinë në mënyrë të përbashkët, mund të autorizojnë disa prej tyre për kryerjen e disa veprimeve të caktuara apo për kryerjen e disa kategorive të caktuara veprimesh.
- 19.4 Këshilli Mbikeqyres mund të shkarkojë Administratorët në çdo kohë.
- 19.5 Administratoret do te veprojne ne perputhje me Statutin dhe Ligjin Tregtar si edhe dispozitat e tjera ligjore ne fuqi, perfshire por pa u kufizuar ne Ligjin per Lojerat e Fatit, detyrime tatimore, parandalimin e pastrimit te parave dhe te mashtrimit ne kuptim te emerimit te tyre dhe gjate ushtrimit te detyres.
- 19.6 Administratoret kane te drejte:
- Te kujdesen per mbajtjen e sakte dhe te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te Shoqerise.
 - Te pergatisin dhe nenshkruajn bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimitarise.
 - Te kryeje aplikimet dhe publikimet e detyrueshme te te dhenave te shoqerise sipas parashikimit te statutit apo te ligjeve te tjera te zbatueshme.
 - Ka kompetenca ekskluzive per përfaqësimin e shoqerise tek palet e treta si edhe te kryeje cdo dhe te gjitha aktivitetet apo transaksionet per menaxhimin, te lidhe kontrata, marreveshje etj pa asnje lloj kufizimi.

TITULLI V **Dividendët dhe Rezervat**

NENI 20 **Dividendët**

- 20.1 Me miratimin e pasqyrave financiare të vitit të mëparshëm finanziar, nga fitimi i realizuar Shoqeria nëpërmjet një Vendimi të Jashtëzakonshëm të Asamblesë së Aksionarëve mund të shpërndajë dividend në favor të Aksionarëve, në përputhje me përqindjen e kapitalit që përfaqësojnë Aksionet e zotëruara prej tyre.
- 20.2 Dividendi paguhet në një ose disa këste, duke pasur parasysh nevojat e likuiditetit të Shoqërisë.

NENI 21 **Rezervat**

- 21.1 Asambleja e Aksionarëve krijon rezerva sipas përcaktimeve të Ligjit Tregtar, dhe me propozim të Këshillit Mbikeqyres, mund të krijojë rezerva të posaçme nga fitimet e aktivitetit të Shoqërisë për mbarëvajtjen e aktivitetit të saj.

TITULLI VI

Neni 22 Rregulloret, Komitetet dhe Marrëveshjet midis Aksionarëve

- 22.1 Asambleja e Aksionarëve me Shumicë të Jashtëzakonshme mund të miratojë rregullore me efekte detyruese, në lidhje me thirrjen, zhvillimin dhe vendimmarjen në mbledhjet e Asamblesë, përfshi këtu procedurat për llogaritjen e kuoromit e të numërimit të votave sipas Ligjit Tregtar, si dhe për çdo çështje tjeter që konsideron të nevojshme për mbarëvajtjen e aktivitetit të Shoqërisë.
- 22.2 Asambleja e Aksionarëve me Shumicë të Jashtëzakonshme mund të krijojë Komitete të Posacme, të miratojë rregullore detyruese mbi objektin e tyre, veprimtarinë, organizim/funksionimin, shpërblimit të anëtarëve si dhe mbi ndërveprimet e detyrueshme me organet e tjera të Shoqërisë, përfshi këtu Këshillin Mbikeqyres dhe/ose Administratorët.
- 22.3 Aksionarët mund të lidhin mes tyre marrëveshje për ushtrimin e të drejtës së votës, ndarjen e dividendëve, kalimin e aksioneve apo marrëveshje të tjera që lidhen me ushtrimin e të drejtave e detyrimeve të Aksionarëve në Shoqëri. Shkelja e këtyre marrëveshjeve midis aksionarëve do të përbejë një shkelje të detyrimit të besnikërisë sipas Ligjit Tregtar, duke e detyruar aksionarin mospërbushjes të dëmshpérblejë dëmin e shkaktuar, apo të paguajë penalitete të caktuara midis palëve.

TITULLI VII

Prishja dhe Likuidimi

NENI 23 Prishja dhe Likuidimi

- 23.1 Shoqëria prishet në rastet e parashikuara nga Ligji Tregtar. Prishja e Shoqërisë ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përashtim të rasteve kur ka filluar një procedurë falimentimi.
- 23.2 Shoqëria mund të likuidohet nëpërmjet procedurës normale ose të thjeshtëzuar, sipas parashikimeve të Ligjit Tregtar.
- 23.3 Likuidimi i Shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e Pjesës përkatëse të Ligjit Tregtar.

TITULLI VIII

Dispozita Finale

Neni 24 Emërimi i Organeve të Para të Shoqërisë



- (1) Anëtarët e parë të Këshillit Mbikeqyres të Shoqërisë emërohen personat e listuar në Shtojcën II bashkëngjitur:
- (2) Administrator(ët) e parë të Shoqërisë emërohen personat e listuar në Shtojcën III bashkëngjitur:
- (3) Auditor(ët) e parë të Shoqërisë emërohen personat e listuar në Shtojcën IV bashkëngjitur:
- (4) Emërimi i organeve të para të shoqërisë do të jetë i vlefshëm deri në mbledhjen e parë të Asamblesë.

Neni 25
Të Ndryshme

(1) Ky dokument, duke përfshirë Anekset bashkëngjitur, përbën Aktin e Themelimit dhe Statutin e Shoqërisë, dhe zëvendëson çdo dhe të gjitha kontratat, marrëveshjet e mëparshme apo mirëkuptimet, me gojë ose me shkrim, ndërmjet Themeluesve në lidhje me themelimin e Shoqërisë.

(2) Me pranimin e këtij Statuti, asnjë Aksionar nuk do të konsiderohet se ka hequr dorë nga ndonjë prej të drejtave sipas dispozitave të Ligjit Tregtar. Mos kryerja e përpjekjeve nga secili Aksionar për të ushtruar ndonjë dispozite të këtij Statuti apo të drejtë që i njihet sipas dispozitave të Ligjit Tregtar, nuk do të interpretohet si heqje dore nga një drejtë e tillë ose nga këto drejta në të ardhmen.

(3) Nëse ndonjë kusht apo dispozite e këtij Statuti shpallet e pavlefshme ose e paligjshme ose e pazbatueshme, dispozitat e tjera të Statutit, për sa është e mundur nuk do të ndikohen prej kësaj pavlefshmërie. Në këto raste, Asambleja e Aksionarëve do të zëvendësojë pa vonesa dispozitat e pavlefshme, me dispozita të vlefshme, me qëllim përbushjen e objektit të Shoqërisë.

(4) Nëse midis Aksionarëve apo midis Shoqërisë dhe Aksionarëve do të lindë ndonjë mosmarrëveshje në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij Statuti dhe me ushtrimin e të drejtave të Aksionarëve sipas Ligjit Tregtar ("Mosmarrëveshja"), secila nga Palët në Mosmarrëveshje do t'i japë Palës tjetër në Mosmarrëveshje njoftim me shkrim në lidhje me këtë Mosmarrëveshje, duke parashikuar shkaqet e Mosmarrëveshjes ("Njoftimi i Mosmarrëveshjes"), pas së cilës Palët do të takohen menjëherë dhe do të përpilen me mirëbesim të arrijnë një zgjidhje me pajtim në përputhje me legjislacionin shqiptar për ndërmjetësimin tregtar në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Nëse Mosmarrëveshjet nuk arrihen të zgjidhen me mirëkuptim si më sipër brenda 45 (dyzetë e pesë) Ditëve të Plota nga Njoftimi i Mosmarrëveshjes, atëherë Palët në Mosmarrëveshje mund t'i drejtohen organeve gjyqësore sipas ligjt në fuqi.

(5) Ky Statut nënshkruhet në 4 kopje ne shqip.

(6) Ky Statut do të rregullohet dhe interpretohet në përputhje më legjislacionin e Republikës së Shqipërisë. Për sa nuk parashikohet në këtë Statut, zbatohen dispozitat e Ligjit Tregtar.

(7) Autorizohet Z. Lulzim Merdani per regjistrimin dhe kryerjen e te gjithe veprimeve ligjore per regjistrimin e Shoqerise prane Qendres Kombetare te Biznesit.

(8) Nenshkruhet sot me date 27.01.2025.

THEMELUESI

Shoqëria "REGENCY INTERNATIONAL CASINO TIRANA" SHA

Perfaqësuar nga Z. Lulzim Merdani



ANEKSI I
(Themeluesit/Aksionet e nënshkruara/Kontributet)

Shoqëria "REGENCY INTERNATIONAL CASINO TIRANA" SHA e krijuar dhe funksionon sipas legjislacionit shqiptar, me seli ne Rrugë Deshmoret e 4 Shkurtit, Parku Rinia, Kompleksi Taiwan, Zona Kadastrale 8380, Tirane, Shqiperi, themeluar dhe regjistruar si person juridik shqiptar me NIPT K51711801L, perfaqesuar nga Administratori Z. Lulzim Merdani shtetas Shqiptar, lindur me 21.07.1967, ne Berat, i pajisur me Leternjoftimin me Nr. Personal G70721094L, zotërues i **50 000 (pesedhjete mijë)** aksioneve me vlerë nominale **1 000 (njëmijë)** lek secila, për një vlerë të përgjithshme kontributi prej **50 000 000 (pesedhjete milion leke)** leke, që përfaqësojnë **100%** të kapitalit filletar, tërësisht të nënshkruara dhe të shlyera në vlerën totale përparrë Regjistrimit të shoqërisë.



ANEKSI II
(Anëtarët e Parë të Këshillit Mbikëqyrës)

Name/Surname (Emri/Mbiemri)	Date of Birth (Datëlindja)	Place of Birth (Vendlindja)	Citizenship (Shtetësia)	Term of Appointment (Afati i Emëritimit)
Edvin Toska	31.05.1980	Fier	Shqiptare	3 vjet nga 27.01.2025 - 27.01.2028
Type of ID (Lloji i dokumentit)	Number of ID (Nr. Personal)	Are the representation powers limited? (Ka kufizime në targat e përfaqësimit?)		Insert limitation, if any (Nëse ka kufizime shëno)
Karte Identiteti	100531072N	Yes/Po <input type="checkbox"/>	No/Jo <input checked="" type="checkbox"/>	
Address (Adresa)	Tirane	Kryetar		


Name/Surname (Emri/Mbiemri)	Date of Birth (Datëlindja)	Place of Birth (Vendlindja)	Citizenship (Shtetësia)	Term of Appointment (Afati i Emëritimit)
David Çaushi	16.08.2002	Roskovec	Shqiptare	3 vjet nga 27.01.2025 - 27.01.2028
Type of ID (Lloji i dokumentit)	Number of ID (Nr. Personal)	Are the representation powers limited? (Ka kufizime në targat e përfaqësimit?)		Insert limitation, if any (Nëse ka kufizime shëno)
Pasaporte	K20816015C	Yes/Po <input type="checkbox"/>	No/Jo <input checked="" type="checkbox"/>	
Address (Adresa)	Tirane	Anëtar		

Name/Surname (Emri/Mbiemri)	Date of Birth (Datëlindja)	Place of Birth (Vendlindja)	Citizenship (Shtetësia)	Term of Appointment (Afati i Emëritimit)
Everest Demushi	13.06.1981	Tropoje	Shqiptare	3 vjet nga 27.01.2025 - 27.01.2028
				

Name/Surname (Emri/Mbiemri)	Date of Birth (Datëlindja)	Place of Birth (Vendlindja)	Citizenship (Shtetësia)	Term of Appointment (Afati i Emëritimit)
Type of ID (Lloji i dokumentit)	Number of ID (Nr. Personal)	Are the representation powers limited? (Ka kufizime në targat e përfaqësimit?)		Insert limitation, if any (Nëse ka kufizime shëno)
Pasaporte	110613183R	Yes/Po <input type="checkbox"/>	No/Ja <input checked="" type="checkbox"/>	
Address (Adresa)	Tirane	Anëtar		


ANEKSI III
(Administrator i Parë)

Name/Surname (Emri/Mbiemri)	Date of Birth (Datëlindja)	Place of Birth (Vendlindja)	Citizenship (Shtetësia)	Term of Appointment (Afati i Emëritimit)
Angelos Theodoridis	24.09.1972	Greqi	Shqiptare	3 vjet nga 27.01.2025 - 27.01.2028
Type of ID (Lloji i dokumentit)	Number of ID (Nr. Personal)	Are the representation powers limited? (Ka kufizime në targat e përfaqësimit?)	Insert limitation, if any (Nëse ka kufizime shëno)	
Pasaporte	H20924179H	Yes/Po <input type="checkbox"/>	No/Jo <input checked="" type="checkbox"/>	
Address (Adresa)	Titane	Administrator		



ANEKSI IV
(Auditor)


Ekspert Kontabë i Autorizuar / Auditor	Dokumenti i Identifikimit/ Identification Document	Autoriteti Licensues / Licensing Authority	Data e Licensës / License Date	Numri i Licensës / License number
Leonidha Foti	G20104089V	IEKA	31.03.2006	150



TRË DHËNA QË NJOFTOHEN VULLNETARISHT

Tel; 0684000847

Email; lulzim_merdani@yahoo.com

A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Lulzim Merdani".

"REGENCY INTERNATIONAL CASINO TIRANA SHA" me NUIS K51711801L

Ne Tirane, sot me date **27.01.2025** (dymije e njezete e pese), ne seline e Shoqerise REGENCY INTERNATIONAL CASINO TIRANA SHA, shoqëri aksionare e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NUIS K51711801L me seli në adresën Rruga "Dëshmorët e 4 Shkurtit", Parku Rinia, Kompleksi TAIWAN, Tirane-Albania u mblođhen aksioneret e shoqerise si me poshte:

- Shoqeria **"GAMING INVEST" SHPK** e krijuar dhe funksionon sipas legjislacionit shqiptar, me seli ne Rruga Deshmoret e 4 Shkurtit, Parku Rinia, Kompleksi Taiwan, , Zona, Kadastrale 8380, Tirane, Shqiperi, themeluar dhe regjistruar si person juridik shqiptar me NIPT M01321020E e perfaqesuar nga Administratori **Z. Skënder Sulaj**, shtetas Shqiptar, lindur me 28.10.1959, ne Panahor, i pajisur me Pashaporten Shqiptare Nr. Personal F91028103D, shoqeri e cila zoteron 51 % te aksioneve te Shoqerise REGENCY INTERNATIONAL CASINO TIRANA SHA.
- Shoqeria **TAIVAN PARK CENTER-TPC SHPK** e krijuar dhe funksionon sipas legjislacionit shqiptar, qender ne Rruga Deshmoret e 4 Shkurtit, Parku Rinia, Kompleksi Taiwan, Nr.Pasurie 7/309, Zona, Kadastrale 8380, Tirane, Shqiperi, themeluar dhe regjistruar si person juridik shqiptar me NIPT L92224012M. Perfaqesuar nga Administratori **Z. Skënder Sulaj**, shtetas shqiptar, i pajisur me Pashaporten Shqiptare Nr. Personal F91028103D , shoqeri e cila zoteron 49 % te aksioneve te Shoqerise REGENCY INTERNATIONAL CASINO TIRANA SHA.

Rendi i dites:

- Krijimin e Shoqerise se re NOVABET Shoqeri Aksionere me themelues/aksioner Shoqerine REGENCY INTERNATIONAL CASINO TIRANA SHA. Kapitali i Shoqerise do te jete 50 000 000 leke me 50 000 aksione nga 1000 leke secili, objekti i shoqerise do te jete "Baste Sportive Online/Import-Export te pajisjeve dhe materialeve lidhur me Baste Sportive Online/Çdo aktivitet tjeter lidhur me Baste Sportive Online ne perputhje me legjislacionin e zbatueshem Shqiptar".
- Organet e Shoqerise do te perfaqesohen nga Z. Angelos Theodoridis ne cilesine e Administratorit si dhe Anetaret e Keshillit Mbikeqyres Z. Edvin Toska, Z. David Çaushi, Z. Everest Demushi,
- Autorizohet Administratori i Shoqerise REGENCY INTERNATIONAL CASINO TIRANA SHA perfaqesuar nga Z. Lulzim Merdani per nenshkrimin e Akt Themelimit dhe Statutit.

Pas diskutimit te rendit te dites, aksioneret e Shoqerise vendosen si me poshte;

VENDOSEN

- Krijimin e Shoqerise se re NOVABET Shoqeri Aksionere me themelues/aksioner Shoqerine REGENCY INTERNATIONAL CASINO TIRANA SHA. Kapitali i Shoqerise do te jete 50 000 000 leke me 50 000 aksione nga 1000 leke secili, objekti i shoqerise do te jete "Baste Sportive Online/Import-Export te pajisjeve dhe materialeve lidhur me Baste Sportive Online/Çdo aktivitet tjeter lidhur me Baste Sportive Online ne perputhje me legjislacionin e zbatueshem Shqiptar".
- Organet e Shoqerise do te perfaqesohen nga Z. Angelos Theodoridis ne cilesine e Administratorit si dhe Anetaret e Keshillit Mbikeqyres Z. Edvin Toska, Z. David Çaushi, Z. Everest Demushi,

- Autorizohet Administratori i Shoqerise REGENCY INTERNATIONAL CASINO TIRANA SHA perfaqesuar nga Z. Lulzim Merdani per nenshkrimin e Akt Themelimit dhe Statutit.



Shoqeria "GAMING INVEST" SHPK

Perfaqesuar nga Skender Sulaj

Skender Sulaj

Shoqeria TAIVAN PARK CENTER-TPC SHPK

Perfaqesuar nga Skender Sulaj

Skender Sulaj

